

KODI I BIZNESEVE KUNDËR KORRUPSIONIT

2024

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

KODI I BIZNESEVE KUNDËR KORRUPSIONIT

I. Dispozitat fillestare: Përmbajtja dhe qëllimi

Nëpërmjet këtij Kodi, të përgatitur nga grantmarrësi i Aktivitetit të USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës, Instituti Riinvest, nënshkruesit e tij zotohen se do të zbatojnë standardet më të avancuara të etikës, transparencës dhe të integritetit në aktivitete e tyre biznesore, se do të shmangin me vendosmëri çdo formë të përfshirjes në raste të korrupsionit, ofrimit të dhuratave apo favoreve tjera zyrtarëve publik apo personave tjerë zyrtarë apo privat, që kanë për qëllim sigurimin e privilegjeve apo përfitimeve të paligjshme në favor të kompanisë.

Kodi ka për qëllim që t'i ndihmojë sektorit privat të zbatojnë aktivitete të drejta, transparente dhe ligjore.

Kodi përkufizon norma, aktivitete dhe nxitë motivimin e subjekteve ekonomike për t'i përvetësuar dhe zbatuar standardet më të mira ndërkombëtare për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit nga ana e ofertës, përkatësisht korrupsionin nga ana e sektorit privat.

Dispozitat e këtij dokumenti reflektojnë komentet dhe sugjerimet e përfaqësuesve të shoqatave të bizneseve, sugjerimet e përfaqësuesve të një numri të konsiderueshëm të sektorit privat, të shprehura gjatë procesit konsultativ për hartimin e Kodit Anti-korrupsion si dhe të shprehura në hulumtimin në kuadër të projektit: "Kodi dhe koalicioni i bizneseve kundër korrupsionit" është pjesë e projektit "Integriteti i sektorit privat; korrupsioni nga ana e ofertës", i financuar nga Aktiviteti i USAID për Integritet të Komunave të Kosovës dhe i zbatuar nga Instituti Riinvest.

Në dispozitat në vijim do të specifikohen fushat dhe objektivat e angazhimit të organeve drejtuese, menaxhmentit të lartë, të zyrtarëve dhe të punëtorëve të kompanive, me qëllim të krijimit të një ambienti refuzues për çfarëdo forme të korrupsionit dhe të veprimeve antiligjore që kanë qëllim të sigurojnë ndonjë pozicion konkurrues të pamerituar.

II. Dispozitat kryesore: fushat dhe objektivat

Neni 1

Nënshkruesit e këtij Kodi, zotohen se nuk do të tolerojnë asnjë formë të korrupsionit direkt apo indirekt, dhe në mënyrë aktive do të mbështesin çfarëdo iniciative që për qëllim ka luftimin e tij dhe do të angazhohen që gjatë çdo aktiviteti biznesor të sillen konform parimeve etike duke mbështetur konkurrencën e lirë dhe të drejtë.

Neni 2

Përmes këtij Kodi, asociacionet dhe organet drejtuese të bizneseve shprehin zellin dhe gatishmërinë që:

1. Në planet e tyre strategjike, bizneset do të kujdesen që qëndrueshmërinë dhe forcimin e konkurrencës në treg ta zhvillojnë duke u bazuar në ngritjen e performancës së tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efikase, dhe do të shmangin çfarëdo veprimi të palejueshëm për të arritur favore apo përparësi në treg.

2. Në rregulloret, politikat, dhe procedurat e biznesit, të zhvillojnë standarde të integritetit që shërbejnë si kode të sjelljes për punëtorë në të cilat ceket qartë përkushtimi i pronarëve, drejtorëve dhe punëtorëve drejt standardeve dhe integritetit; të bërit biznes në mënyrë të drejtë, të sinqertë dhe të hapur.
3. Rregulloret, politikat, dhe procedurat e biznesit do të ndalojnë çfarëdo praktike e cila është në kundërshtim me konkurrencën e drejtë dhe praktika të cilat mund të ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës. Punëtorët e kompanisë nuk duhet të ndërmarrin veprime të cilat pengojnë interesat legjitime të konsumatorëve ose operacioneve tjera në kundërshtim me Ligjin mbi Konkurrencën.
4. Në aktet e brendshme normative të kompanive do të ndalohet dhe do të sanksionohet shprehimisht dhënia e ryshfetit dhe hyrja në çfarëdo aktiviteti të dyshimtë të kësaj natyre të përfaqësuesve apo të zyrtarëve tjerë të kompanisë dhe kjo do të sanksionohet si shkelje e rëndë disiplinore ndaj të cilës duhet të parashihen edhe masa adekuate ndëshkimore deri te largimi i tyre nga puna. Në aktet e brendshme do të ceket se kompania ka zero tolerancë ndaj korrupsionit. Do të ceket qartë se asnjë punëtor nuk duhet të ofroj gjëra me vlerë zyrtarëve publik e privat për të siguruar avantazh të padrejtë për biznesin e tyre. Biznesi ndalon pagesat dhe ofertat për pagesë, të bëra në mënyrë direkte ose indirekte me qëllim të përfitimit të avantazhit të padrejtë për biznesin apo ndonjë përfitimi personal.
5. Me dispozitat e akteve të brendshme juridike, sektori privat, duhet të sigurojë një sistem stimulativ të transparencës dhe të raportimit të rasteve të dhënies së ryshfetit apo tentimit për të hyrë në çfarëdo aktiviteti të ndaluar me ligj.
6. Përgatitja e pasqyrave financiare do të bëhet konform parimeve të pranuar të kontabilitetit. Asnjë zë i rremë ose mashtrues nuk mund të bëhet në libra dhe regjistrime të kompanisë për çfarëdo arsye, dhe asnjë punonjës nuk mund të përfshihet në ndonjë marrëveshje që rezulton në akte të tilla të ndaluara.
7. Të krijohen standardet të brendshme të kontrollit të auditimit, të cilat do të reflektojnë standardet kundër ryshfetit dhe do të bëjnë transparent raportin e auditorit.
8. Me aktet e brendshme juridike do të sigurojnë shmangien e konfliktit të interesit, qoftë në rastet e hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me autoritetet publike apo edhe me ato private.
9. Do të zhvillojnë politika të brendshme të cilat dekurajojnë personelin që të hyjnë në veprime korruptive përmes masave ndëshkuese duke i dënuar rastet e tilla dhe, u ofrojnë stimuj atyre që kanë kontribuar ndaj luftimit të korrupsionit.
10. Të pranojnë standardet e transparencës, sidomos në prokurim publik, duke përfshirë edhe mbështetjen e monitorimit e procedurave dhe procesin e implementimit të kontratave të ndërlydhura me prokurim publik.
11. Në mënyrë të veçantë, nënshkruesit e këtij Kodi do të angazhohen që të sigurohet transparencë dhe monitorim rigoroz të kontratave me autoritetet publike duke përfshirë ofertën financiare, afatet dhe cilësinë në punimet, gjegjësisht shërbimet që janë objekt i këtyre kontratave.
12. Të sigurojnë transparencë të plotë dhe parime etike për kontributet ndaj partive politike dhe sponsorizimet, dhe të mbajnë shënime për të gjithë kontributet e bëra për këtë qëllim.

Neni 3

Kërkesat për marrje ryshfeti, apo çfarëdo kushtëzimi tjetër nga ana e zyrtarëve publik për të krijuar favore të pamërituara për operatorin ekonomik, do të raportohen menjëherë në organet përkatëse për krime ekonomike.

Sistemi i Sinjalizuesve

Neni 4

1. Nënshkruesit e këtij Kodi, përkushtohen që do të ndërtojnë një sistem sinjalizimi në përputhje me ligjin në fuqi i cili do të jetë i disponueshëm për të gjithë punonjësit, dhe palët e jashtme të interesuara.
2. Në çdo rast, nënshkruesi i këtij Kodi garanton konfidencialitet të rreptë të identitetit të sinjalizuesit, personit për të cilin ka të bëjë denoncimi dhe faktet që janë paraqitur në raport. Raportet e sinjalizuesve trajtohen në konfidencialitet të plotë, duke iu nënshtruar detyrimeve ligjore në fuqi dhe çdo procedimi administrativ ose ligjor.
3. Sinjalizuesit e rasteve të korrupsionit dhe të formave të tjera të kësaj natyre kundërligjore duhet të sigurohen se nuk do të kenë asnjë pasojë për këto veprime.
4. Bazuar në paragrafet e mësipërme, bizneset duhet të hartojnë rregullore ose procedura të brendshme për statusin e sinjalizuesit.

Trajnimit i stafit dhe kampanja e vetëdijesimit

Neni 5

1. Organet drejtuese të biznesit do të kujdesen që të sigurojnë udhëzues me të cilin stafi i tyre do të njoftohet me të gjitha kategoritë korruptive, pasojat ligjore në rastet kur hyhet apo tentohet të hyhet në aktivitete të tilla.
2. Palët nënshkruese të këtij Kodi, përkushtohen që do të organizojnë trajnime për punonjësit për t'u njohur më këtë Kod dhe trajnime të organizuara nga biznesi me qëllim ngritjen e vetëdijes, integritetit, dhe ndërgjegjësimit në luftën kundër korrupsionit brenda biznesit.
3. Palët nënshkruese do të iniciojnë, apo do të përfshihen në fushata për vetëdijesimin e qytetarëve për dëmet dhe pasojat e përfshirjes së tyre në çfarëdo forme të korrupsionit.

Integriteti i sektorit privat në proceset e prokurimit publik

Neni 6

1. Bizneset do të angazhohet të zbatojnë të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi që lidhen me kontratat dhe shërbimet publike (prokurimin publik) dhe do të sigurojnë që raportet, certifikimet, dhe deklaratat e tyre ndaj zyrtarëve publik të jenë të sakta dhe të plota.
2. Për stafin që punon në sektorin e përgatitjes së ofertave për autoritetet kontraktuese dhe atë që bënë monitorimin dhe implementimin e kontratave, do të organizohen trajnime brenda bizneseve në lidhje me rregullativën ligjore kundër korrupsionit, lidhur me parimet etike në të bërit biznes dhe rreziqet për pasojat individuale dhe të kompanive në rast të përfshirjes në ndonjë aferë të palejueshme dhe korruptive.

3. Sipas nevojës, në trajnimet sipas paragrafit paraprak, do të sigurojnë edhe ekspertë të jashtëm, e në raste të caktuara edhe ndërkombëtarë, sidomos për të përcjellë përvojat ndërkombëtare në ballafaqimin dhe parandalimin e këtyre dukurive të dëmshme.
4. Në lidhje me dy paragrafët paraprak të këtij neni, subjektet ekonomike do të hartojnë plane të detajuara.
5. Nënshkruesit e këtij Kodi zotohen që nuk do të kontaktojnë, ndikojnë ose ushtrojnë presion në mënyrë direkte ose indirekte ndaj anëtareve të komiteteve vlerësuese, ose punonjësve të zyreve të prokurimit me qëllim për të marrë kontratë ose përfituar ndonjë favor.
6. Të gjithë punonjësit do të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre jo etike në procesin e prokurimit.
7. Stafi i njësisë së prokurimit/personat përgjegjës nuk duhet të lejojnë që aktivitetet e tyre të ndikohen nga persona të paautorizuar apo kërkesa të mundshme për rryshfet ose çdo formë favor.
8. Stafi i njësisë së prokurimit nuk do të ndajë asnjë informacion me bizneset e tjera në lidhje me ofertën.

Vlerësim paraprak gjithëpërfshirës (Due diligence)

Neni 7

1. Me qëllim të ruajtjes së reputacionit të bizneseve, do të shmangen marrëdhëniet kontraktuale dhe çfarëdo bashkëpunimi me ato subjekte të cilët nuk i pranojnë parimet etike në të bërit biznes apo në çfarëdo forme bien ndesh me dispozitat e këtij Kodi.
2. Të vlerësohet cilësia e brendshme e partnerit biznesor (siç janë: historia penale, sanksionet, reputacioni, dhe integriteti) dhe kontrollimi i kushteve ligjore, ekonomike dhe materiale të ndërlidhura me marrëdhënien biznesore (shembull: struktura organizative e partnerit biznesor, kontratat, struktura ligjore dhe financiare, dhe kushtet e pagesës).
3. Duke bërë një vlerësim paraprak gjithëpërfshirës (due diligence) të tij përpara se të hyjë në një marrëdhënie biznesi, sektori privat mbrohet nga çdo rrezik reputacioni ose rreziku të sanksioneve që lidhen me praktikat e paligjshme.

Iniciativat për përmirësimin e kornizës ligjore

Neni 8

Nënshkruesit e këtij Kodi do t'i marrin në konsideratë parimet e OECD-së për qeverisje korporative dhe përgjegjësi sociale korporative, të cilat do të kontribuojnë në mbrojtjen e reputacionit të biznesit dhe të marrëdhënieve profesionale me hisedarët, punëtorët, furnitorët, nën-kontraktorët, konkurrentët, konsumatorët, dhe qeverinë.

Neni 9

Do të ndërmarrin iniciativa për përmirësimin e rregullativës ligjore në lidhje me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, nëse konstatohet se nene të caktuara apo edhe ligjet përkatëse nuk janë të zbatueshme

apo nuk janë të mjaftueshme për ndjekjen dhe ndëshkimin e individëve të cilët përfshihen në aktivitete kriminale ekonomike dhe korruptive.

Neni 10

Do të jenë pjesë e çfarëdo iniciative për artikulumin dhe ngritjen e zërit protestues ndaj institucioneve kompetente nëse ato nuk janë sa duhet aktive në hetimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për aferat korruptive.

Neni 11

Nënshkruarit e këtij Kodi kërkojnë që autoriteti përkatës të hapë një faqe të internetit/platformë online ku do të publikoheshin të gjitha shkeljet procedurale, rastet korruptive dhe masat që ndërmerren kundër individëve apo kompanive që hyjnë në afera të palejuara dhe korruptive në procedurat e prokurimit publik.

Neni 12

Anëtarësia e shoqatave dhe personeli i sektorit privat do të jenë të informuar për përmbajtjen dhe objektivat e Strategjisë Nacionale Anti-korrupsion dhe do të jenë të inkurajuar për t'i përfillur këto objektiva dhe do të nxiten që të marrin pjesë aktive në zhvillimin dhe avancimin tyre.

Neni 13

Nënshkruarit e këtij Kodi do të marrin në konsideratë Strategjinë e BE-së kundër korrupsionit, konventat ndërkombëtare dhe instrumentet më efektive ndërkombëtare për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Dhuratat, donacionet dhe sponsorizimet

Neni 14

1. Donacionet dhe aktivitetet e sponsorizimit do të autorizohen vetëm nëse respektohen ligjet dhe rregulloret në fuqi.
2. Nënshkruarit e këtij Kodi zotohen që donacionet dhe aktivitetet e sponsorizimit nuk do të përdoren me qëllim për të marrë ose ofruar një avantazh të padrejtë ose për të ndikuar në një vendim.
3. Asnjë donacion për entitete bamirësie apo parti politike nuk mund të përdoret si metodë për ryshfet, favore apo veprime të tjera korruptive. Nënshkruarit zotohen që do të përmbahen nga dhënia e donacioneve në rast se ndonjë rrethanë mund t'i bëjë këto të duken si ryshfet ose veprime korruptive.
4. Palët nga sektori privat përkushtohen që do të hartojnë rregulloret të detajuara në lidhje me sponsorizimet dhe donacionet.

III. Dispozitat përfundimtare

Neni 15

Nënshkruarit pajtohen që të formohet një Komitet mbikëqyrës për zbatimin e këtij Kodi i përbërë me nga një përfaqësues të Asociacioneve iniciatore për nënshkrim të këtij Kodi. Komiteti do të kryesohet me

rotacion, secilin vit, dhe do të takohet se paku një herë në 6 muaj për të diskutuar ecuritë në zbatimin e këtij kodi.

Neni 16

Nënshkrimi i këtij Kodi është vullnetar.

Neni 17

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Kodi mund të bëhen me iniciativën e së paku 1/3 e nënshkruesve, ndërsa aprovimi i tyre bëhet me pëlqimin e të gjithë nënshkruesve.

Neni 18






Lista e nënshkruesve të këtij Kodi është e hapur në vijimësi për të gjitha bizneset nga sektori privat dhe shoqatat e bizneseve që i pranojnë dispozitat e këtij Kodi dhe shprehin vullnetin për të qenë pjesë e tij dhe për ta nënshkruar.

Asociacionet e bizneseve mund t'i kushtëzojnë/inkurajojnë bizneset e reja të cilat dëshirojnë të anëtarësohen në shoqatë që paraprakisht ta nënshkruajnë këtë Kod.

Vendi dhe data:

Prishtinë, 26 Mars 2024

Lista e Asociacioneve të bizneseve nënshkruese të Kodit:

1. Oda Ekonomike e Kosovës
Lulzim Rafuna, Kryetar

2. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
Arian Zeka, Drejtor Ekzekutiv *-Pëllumb Shek*

3. Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare
Nora Hasani, Drejtoreshë Ekzekutive

4. Klubi i Prodhuesve të Kosovës
Astrit Panxha, Drejtor Ekzekutiv

5. Rrjeti CSR Kosova
Zana Bajrami – Rama, Drejtoreshë Ekzekutive

6. Shoqata Esnaf
Vasir Xhejllani, Kryetar
